



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

29 mars 2012

Dokument Veprimi për Asociacionin e Gazetarëve Profesionistë të Kosovës

Liria e Shprehjes në Media dhe Roli i Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	7
II. Spektri i medieve	8
1.1 Pasqyrë e shkurtër e publikimeve të mediave dhe organet rregullatore për media	8
2.2 Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, AGPK	9
III. Të gjeturat e Pulsit Publik	11
IV. Korniza Legjislative e lirisë së shprehjes	13
4.1 Përmbledhje e legjislacionit ekzistues dhe zbatueshmëria	13
4.2 Ndryshimet e parapara legjislative për vitin 2012 dhe pasojat e mundshme mbi lirinë e shprehjes.....	13
V. Kosova në Indeksin për Lirinë e Shprehjes	15
5.1 Raportet Ndërkombëtare.....	15
5.2 Këndvështrimi dhe vlerësimi nga ana e medieve dhe gazetarëve të Kosovës	16
VI. Rekomandimet dhe veprimet pasuese.....	18

Dokument Veprimi për Asociacionin e Gazetarëve Profesionistë të Kosovës

29 mars 2012

Liria e Shprehjes në Media dhe Roli i Asociacionit të Gazetarëve
Profesionistë të Kosovës

LISTA E SHKURTESAVE

AMPEK	Asociacioni i Medieve të Pavarur Elektronike në Kosovë
AGPK	Asociacioni i Gazetarëve Profesionist në Kosovë
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
KE	Komisioni Evropian
ECHR	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
ICCPR	Protokolet dhe Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
IREX	Bordi Ndërkombëtar për Studime dhe Shkëmbime
KTV	Kohavision
RTK	Radio Televisioni of Kosëvo
RTV21	Radio Television 21
KPSHK	Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës
UNDEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Demokraci
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UDH	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

I. Hyrje

Në vitin 2010 UNDP filloi me implementimin e Projektit të Pulsit Publik, e që mbështetet në përvojën disavjeçare të publikimit të Raporteve të Paralajmërimit të Hershëm, vazhdon të hulumtojë dhe analizojë çështjet më me interes në Kosovë me qëllim të shtimit të dialogut në mes të institucioneve të qeverisë dhe qytetarëve në përgjithësi. Raporti Pulsi Publik zgjeron analizat nga paralajmërimi i hershëm dhe parandalimi i konfliktit për t'u përqëndruar më tepër në dialog demokratik dhe monitorim të stabilitetit institucional. Përmes analizave gjashtëmujore dhe debatit pasues, Raporti dhe të dhënat nga anketimi, në të cilat edhe bazohen raportet, gjithashtu shërbejnë si një bazë për identifikimin e çështjeve më të rëndësishme me interes për publikun dhe formësimin e opinionit të tij. Një element i ri i Projektit Pulsi Publik është përgatitja e Dokumentit për Veprim i cili fokusohet në një trend të përzgjedhur apo çështje që rezultojnë të jetë me interes të veçantë për publikun. UNDP, identifikon një institucion të caktuar për analizë shënjestër, dhe në partneritet me atë institucion, angazhohet në përgatitjen e Dokumentit të veprimit duke u zhytur më thellë në çështje. Dokumenti shërben si një mekanizëm pasues për të ofruar ide për veprime që do të adresojnë çështjen në fjalë. Sipas të gjeturave të Projektit Pulsi Publik, shumica e kosovarëve (60%) mendojnë që Mediet Kosovare nuk gëzojnë liri të shprehjes, dhe për më tepër rreth 50% e qytetarëve formojnë opinionet e tyre për çështjet kyçe me të cilat përballet Kosova përmes medieve – edhe pse perceptimi i tyre është që mediet në Kosovë nuk gëzojnë liri të shprehjes. Duke marrë parasysh rolin thelbësor të gazetarëve për këtë Dokument Veprimi, UNDP ka përzgjedhur Asociacionin e Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK) si institucion për analiza të mëtutjeshme.

Së këndejmi, Dokumenti i Veprimit ofron një pasqyrë të spektrit të medieve dhe kornizës ligjore për lirinë e shprehjes në Kosovë. Identifikon trendët dhe sfidat kryesore për praktikën e lirisë së shprehjes në medie, ekzaminon arsyet prapa rënies së besimit në perceptimin publik, vlerëson misionin dhe rolin e AGPK-së dhe ofron rekomandime për përmirësim. Qëllimi i këtij Dokumenti për Veprim është që të kontribuojë drejt fuqizimit të komunikimit dhe bashkëpunimit mes palëve të interesit (medies, gazetarëve dhe publikut) duke siguruar që AGPK si institucioni në shënjestër të angazhohet më pas në përmirësimin e praktikave dhe kushteve në terren. Ky Dokument Veprimi është i kufizuar në fushëveprim, dhe qëllimi i tij nuk është të jetë një krye-dokument i cili ngërthen në vete të gjitha çështjet dhe sfidat me të cilat përballet mediet. Ky Dokument synon të ekzaminojë çështjet që ndikojnë në perceptimin negativ të publikut për lirinë e shprehjes në Kosovë dhe të ofrojë disa rekomandime dhe përmirësime të mundshme të cilat për një afat të shkurtër apo të mesëm do të mund kontribuonin në zhvillimet pozitive në këtë sektor.

II. Spektri i medieve

1.1 Pasqyrë e shkurtër e publikimeve të mediave dhe organet rregullatore për media

Spektri i medieve në Kosovë përbëhet nga media e shtypit, media elektronike dhe mediet transmetuese. Ekzistojnë tetë gazeta ditore nacionale. Sipas statistikave për qarkullimin e gazetave, *Koha Ditore* është gazeta kryesore pasuar nga *Kosova Sot*¹. Që të tetë gazetat kanë një qarkullim ditor prej 25,000 dhe 35,000 kopjesh². Ekzistojnë gjithashtu 22 stacione televizive: katër stacione televizive të nivelit kombëtar, transmetuesi publik Radio Televizioni i Kosovës (RTK) dhe radiotelevizionet private si Radio Televizioni 21 (RTV21), Kohavision (KTV) dhe Klan Kosova. Aktualisht në Kosovë operojnë 92 radio stacione: katër radio stacione nacionale të cilat përfshijnë dy publike, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky, dhe dy private, Radio 21 dhe Radio Dukagjini³. Rejtingu i transmetimeve ka dhënë këto përqindje: RTK 52 %, KTV 28 %, RTV21 49 %, Radio Dukagjini 8 %, Radio Kosova 5 %, Radio 21 2 %⁴. Nuk ka të dhëna mbi të hyrat vjetore nga reklamat në sektorin e medias. Ndërsa agjenci të lajmeve dhe portaleve të informacionit janë Kosova Live, Kosova press, Telegrafi, Indeksonline etj. Për më tepër shumica e gazetave gjithashtu kanë edhe edicionet e tyre online. Në ndërkohë statistikave të përdorimit të internetit tregojnë që 53% e ekonomive familjare kanë qasje në internet⁵. Për më tepër nuk ka statistika mbi lexueshmërinë e medieve online. Në një studim të zhvilluar nga Index Kosova, 86% e të intervistuarve kanë deklaruar që lajmet i marrin nga TV, 7% nga shtypi dhe rreth 5% nga radio⁶.

Institucionet kryesore rregullative janë Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe Këshilli për Media e Shtypit (KMSH). KPM rregullon spektrin e medieve i cili është i përcaktuar me Nenin 131 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe është i themeluar me Ligjin nr.02/L-15 mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetimin⁷. Asociacioni i Medieve të Pavarura Elektronike të Kosovës i cili përfaqëson rreth 70% të medieve elektronike punon shumë afër me KPM, në veçanti në procesin që ka të bëjë me digitalizimin⁸. Për më tepër pavarësia e KPM nuk është siguruar në tërësi, meqë në fund të vitit 2011, dy vende të lira në bord nga ana e Kuvendit mbetën të paplotësuara për shkak të ndikimeve politike. Gjithashtu edhe ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për KPM akoma duhet të finalizohet nga qeveria. Përveç ofrimit të licencës, KPM është gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në programet televizive dhe dënimet në rast nevojë edhe pse procedurë e tillë nuk praktikohet nga KPM. KPM gjithashtu nuk ofron hapësirën adekuate dhe nuk u kushton vëmendjen e duhur pranimit të ankesave nga ana e qytetarëve. Derisa në vitin 2011, KMP ka miratuar 12 licenca afatgjate për transmetim⁹, pavarësia editoriale e transmetuesit publik të RTK-së, si transmetuesi më i shikuar në nivelin nacional, akoma nuk është garantuar¹⁰. Sipas të gjeturave nga Puls i Publik, nga të gjitha shërbimet publike kosovarët janë më të kënaqur me RTK-në (40%); ndonëse krahasuar me vitet e kaluara, kënaqshmëria me këtë institucion gjithashtu ka pësuar rënie (shiko figura 1).

1 INDEX Kosova, "Pasqyrë e medieve në Kosovë" 9 dhjetor, 2008. Vizituar më 25 mars 2012. http://www.indexkosova.com/docs/doc2_7.pdf

2 Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), "Qarkullimi dhe politizimi i mediave të shkruara në Kosovë" mars 2010. Vizituar më 25 mars 2012. http://www.kipred.net/web/upload/Circulation_and_Politicization_of_the_Print.pdf

3 Komisioni i Pavarur për Media në Kosovë. "Adresari i Transmetuesve Publik të Licencuar në Kosovë." Vizituar më 25 mars 2012. <http://www.imc-ko.org/IMG/pdf/220.pdf>

4 Ibid 1.

5 Ibid 1.


6 Ibid 2.

7 Komisioni i Pavarur për Media në Kosovë, faqja zyrtare e internetit, vizituar më 25 mars 2012. <http://kpm-ks.org/?faqe=141&gjuha=3>

8 IREX. "Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medieve 2011." Vizituar më 25 mars, 2012 http://www.irex.org/sites/default/files/EE_MSI_2011_Kosovo.pdf

9 Freedom House. "Liria e medieve të shkruara, Kosovë. 2011." Vizituar më 25 mars 2012. <http://www.freedomhouse.org/report/freedom-press/2011/kosovo>

10 Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian 2011. Vizituar më 25 mars, 2012. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf

Figura 1. Kënaqshmëria e Kosovarëve m Radio Televizionin e Kosovës

Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK) rregullon çështjet e medieve të shkruara dhe është një organ vet-rregullativ për secilin sektor të medieve të shkruara në Kosovë. Ky Këshill përbëhet nga kryeredaktorët e medieve të shkruara të Kosovës dhe funksionin sipas Kodit Etik të Gazetarisë¹¹. Vendimet e KMSHK nuk kërkojnë nga gazetaret që të paguajnë gjoba, por ato kërkojnë nga gazetaret që të publikojnë tekstet e gjykimeve kundër tyre. Disa prej sfidave të KMSHK-së përfshijnë mospagesën e anëtarëve nga pjesëtarët e tij, mungesën e resurseve humane në zhvillimin e mëtutjeshëm të organizatës, mungesën e fondeve etj.

Në ndërkohë, Kosova gjithashtu ka edhe asociacione profesionale dhe institute. Instituti i Medieve të Kosovës është një organizatë joprofitabile dhe joqeveritare që është përgjegjëse për trajnim dhe shërbën si një qendër për avokim të mediave, themelimi i të cilës u bë pas kërkesës së vet medieve të Kosovës. Grupet tjera përfshijnë edhe Unionin e Gazetarëve të Kosovës (UGK) dhe Asociacionin e Gazetarëve Profesionalistë të Kosovës (AGPK). Të dyja këto organizata janë të njohura për reagimet ndaj shkeljeve të lirisë së shprehjes, organizimin e seminareve të gazetarisë dhe avokimin për standarde më të larta profesionale.

2.2 Asociacioni i Gazetarëve Profesionalistë të Kosovës, AGPK

Asociacioni i Gazetarëve Profesionalistë të Kosovës është një organizatë jo profitabile dhe joqeveritare e themeluar në vitin 2002. Misioni kryesor i AGPK-së është të promovojë dhe të përmirësojë rolin e gazetarëve, avancojë standarde të larta profesionale si dhe të avokojë për të drejtat e gazetarëve dhe të sigurojë mjedis të sigurtë pune. Më e rëndësishmja, AGPK është themeluar për të përmirësuar lirinë e fjalës dhe shprehjes në Kosovë.

AGPK pushoi së funksionuari për një vit, gjatë vitit 2010 deri në fillim të vitit 2011, për shkak të keq menaxhimit të protokolleve dhe financave operative nga bordet që favorizonin grupe të caktuara të medieve¹². Kjo gjë jo vetëm që ka çuar në mosangazhimin e gazetarëve të organizatës, por edhe ka dëmtuar imazhin e përgjithshëm para opinionit publik. Por në mars të vitit 2011, AGPK ka pësuar një ristrukturim organizativ dhe të lidhshpimit. Tani AGPK ka një Bord të ri të Drejtorëve dhe Stafin Ekzekutiv i cili përbëhet nga rreth 100 anëtarë të cilët të gjithë janë gazetarë të regjistruar në AGPK. AGPK është duke zhvilluar një proces të ri-regjistrimit për të azhurnuar listën. Deri tani anëtarësia është bërë mbi bazën e vullnetit. AGPK duhet që të themelojë parakushte të qarta dhe përgjegjësi të definuara për gazetarët që kërkojnë të anëtarësohen, me një shumë simbolike pagese që mundësojnë në kthim shërbime siç do të mund të ishte karta nga Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve¹³.

Në vitin 2011, AGPK gjithashtu ka filluar me implementimin e projektit dyvjeçar të mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Demokraci (UNDEF), i cili fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve, promovimin e lirisë së shprehjes dhe informacionit si dhe ngritjen e kapaciteteve për media të lira, të pavarura dhe pluraliste. AGPK gjithashtu ka përpiluar Strategjinë për Zhvillim 2012-2015, të cilat përqëndrohen në arritjen e një numri Objektivash Strategjike, me qëllim të profesionalizimit të strukturave përfshirë artikullimin e detyrave dhe përgjegjësisë të anëtarëve, drejtorit, bordit, kuvendit dhe vizionin për zhvillim të brendshëm në kuptim të resurseve njerëzore dhe

11 Këshilli i Mediave të Shkruara në Kosovë, faqja zyrtare e internetit. Vizituar më 25 Mars, 2012. <http://www.presscouncil-ks.org/?cid=2,2>

12 Asociacioni i Gazetarëve Profesionalistë të Kosovës. "Strategjia për Zhvillim 2012-2015."

13 Ibid 12.

planifikimit financiar, marrëdhënies me anëtarët e vet dhe publikun, si dhe planet për zhvillimin e iniciativave afatgjate dhe partneriteteve, siç janë qendra për media, trajnimet dhe mekanizmat për mbrojtjen e gazetarëve dhe sigurimin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2011 AGPK ka qenë e angazhuar në organizimin e konferencave dhediskutimeve, mirënjohjen er gazetarisë profesioniste dhe reagimet publike, dhe dhënien e deklaratave mbi politikat dhe veprimet që kanë cenuar gazetarinë e lirë dhe të pavarur, siç janë shkelja e të drejtave të gazetarëve, ndryshimet e dëmshme legislative etj¹⁴. Megjithatë, mund të gjenden informata të pakta në faqen zyrtare të internetit të kësaj organizate mbi rrjedhën dhe proceset e këtyre ngjarjeve në përgjithësi, nivelin deri ku ekziston vazhdimësia e këtyre aktiviteteve, ose mbi marrëdhënien mes AGPK dhe pjesëtarëve të saj. Faqja e internetit gjithashtu nuk posedon doracakë që do të mund t'ju shërbenin gazetarëve si udhëzues dhe të ndihmonin në adresimin e çështjeve të tyre me interes. AGPK nuk ofron as shërbimet elementare gjyqësore, siç mund të jenë udhëzimet apo trajnimet për përgatitjen e qasjes në dokumentet dhe formularët zyrtarë.

Derisa AGPK ka bërë progres në përmirësimin e statusit ligjor dhe ngritjen e profilit dhe krijimit të një numri të partneriteteve, ka gjithashtu nevojë për të zhvilluar tutje edhe kapacitetet e brendshme të organizatës për të siguruar veprimet ditore dhe menaxhimin e zyrës, gjë që do të çonte drejt një marrëdhënie më konsistente me anëtarët e vet, të cilët më pas do të ishin më të angazhuar dhe do të kontribuonin në përpjekjet për të përmirësuar sfidat me të cilat përballen siç është liria e shprehjes.

14 Për shembull, diskutimi për tryezë të rrumbullakët 3 maj Dita e Lirisë së Shtypit, dhe një seri shpërblimesh për gazetari, siç janë Gara vjetori për Gazetari dhe Liri të Shprehjes, Çmimi për Varfërinë, Çmimi për Transparencë dhe Atikorrupsion dhe Çmimi Gazetari i Vitit.. Në dhjetor 2011, AGPK gjithashtu ka mbatur disa seminare për javën e Gazetarisë në temat që përmbajnë pozitën e gazetarëve në Kosovë, etika dhe komentet për portalet, qasja në dokumentet zyrtare, raportimi për të drejtat e njeriut, raportimi për gjyqësinë, raportimi për korrupsionin..

III. Të gjeturat e Pulsit Publik

Të gjeturat e Pulsit Publik							
A ka Liri të Shprehjes në Kosovë		Mashkuj	Femra	Gjithsej	Urban	Rural	Gjithsej
Nënt2010	Jo	68.9%	67.9%	68.4%	72.0%	64.5%	68.4%
	Po	31.2%	32.1%	31.7%	27.9%	35.6%	31.7%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Qersh. 2011	Jo	62.2%	64.1%	63.1%	65.5%	60.3%	63.1%
	Po	37.9%	35.9%	37.0%	34.5%	39.0%	37.0%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Nënt 2011	Jo	68.0%	59.7%	64.0%	68.8%	58.9%	64.0%
	Po	32.0%	40.2%	36.0%	31.3%	41.1%	36.0%
	Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Figura 2. Përceptimi i kosovarëve për lirinë e shprehjes në mediet e Kosovës .

Të gjeturat e fundit të Pulsit Publik tregojnë për një rënie të përgjithshme në kënaqshmërinë e publikut me punën e institucioneve kryesore ekzekutive, legislative dhe gjyqësore, indeksi i përgjithshëm i demokratizimit ishte në 0.92, gjë që tregon që shumica e njerëzve nuk mendojnë që procesi i demokratizimit është duke shkuar në drejtimin e duhur. Përgjegjësia kryesore për situatën aktuale politike në Kosovë është deklaruar të jetë mbi Qeverinë e Kosovës (54%), pasuar pastaj nga partitë politike (17%), dhe EULEX (9%). Ndërkohë Kosovarët kanë identifikuar si probleme kryesore me të cilat ballafaqohen papunësinë (30%), varfërinë (29%) dhe korrupsionin (11%). Për më tepër treguesit e demokratizimit kanë dëshmuar se vetëm një e treta e kosovarëve besojnë që Kushtetuta e Kosovës dhe Ligjet e Kosovës janë demokratike dhe respektojnë të drejtat e njeriut, që pushtetet komunale punojnë sipas prioritetëve të qytetarëve të tyre, dhe që mediet gëzojnë lirinë e shprehjes apo që zgjedhjet janë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare¹⁵.

Në mes të këndvështrimeve të tilla për demokratizimin, perceptimi publik për lirinë e shprehjes në media ka qenë i ultë përgjatë vitit 2010 dhe 2011. Qershori 2011 tregon rënien më të madhe në perceptimin publik që mediet në Kosovë

gëzojnë liri të shprehjes. Rezultatet tregojnë që vetëm një e treta e kosovarëve pajtohen që në Kosovë ekziston liria e shprehjes, dhe kjo përqindje është më e lartë në mesin e grave (40.2%) krahasuar me meshkujt. Ngjashëm, të anketuarit që banojnë në vende rurale kanë më shumë besim në lirinë e shprehjes në Kosovës (41.1%) krahasuar me të anketuarit që jetojnë në zonat urbane (31.3%).

Është e rëndësishme të theksohet që rënia më e madhe e perceptimit publik në qershor 2011, është shënuar pas debateve të shumta publike në dhjetor 2010 lidhur me mashtrimet gjatë zgjedhjeve; rastisë të jetë po në të njëjtën kohë kur janë mbajtur edhe diskutimet në Kuvend lidhur me mos transparencën e bisedimeve teknike mes Prishtinës dhe Beogradit të sponsoruara nga Komisioni Evropian. Por deri në nëntor 2011, diskutimet dhe vëmendja më e madhe ka qenë mbi mungesën e qasjes dhe informacionit lidhur me intervenimin e qeverisë së Kosovës gjatë muajit korrik në Veri të Kosovës. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian (KE) për Kosovën tregon për një progres të kufizuar në reformat ekonomike dhe të qeverisjes, si dhe kanalet dhe mekanizmat për lirinë e shprehjes.

Por mediet vazhdojnë të jenë burimi kryesor i informacionit në Kosovë. Të gjeturat nga Pulsit Publik tregojnë që mediet janë burimi kryesor i informacionit për praninë e korrupsionit (54.9%) dhe krimin e organizuar (69.5%) në Kosovë. Kështu që opinioni publik është kryesisht i formësuar dhe

15 UNDP Kosovë. "Raporti Pulsit Publik 1." Mars 2011. Vizituar më 25 Mars, 2012. <http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/public-pulsenglish-web.pdf>

krijuar nga informata që vijnë përmes medias dhe jo bazuar në përvojat personave të njerëzve me sjellje korruptive .

Nga njëra anë, perceptimi i opinionit publik lidhur me përhapjen e madhe të korrupsionit dhe krimin të organizuar është kryesisht i bazuar në informatat që vijnë nga mediet. Por, nga ana tjetër, shihet një rënie në besueshmërinë që mediet gëzojnë liri të shprehjes. Se këndejmi, përkundër zhvillimeve të lartpërmendura të mesit të vitit 2011, të cilat kanë mundur të ndikojnë perceptimet e tilla, një faktor tjetër i rëndësishëm që meriton të merret parasysh është niveli deri ku mediet kanë mundur të kenë reagime pasuese për rastet më të ndjeshme dhe të nivelit të lartë. Publiku mbase beson që mediat edhe pse fillimisht kanë raportuar në mënyrë të suksesshme për rastet serioze, trendët e zbrapsjes apo identifikimin e sfidave kryesore politike dhe ekonomike, lajmet në masë të madhe kishin formën e një raportimi sipërfaqësor e jo të një gazetarie thellësisht hulumtuese – dhe kështu dështuan që të përcjellin këto çështje përmes analizave detajore të bazuara në dëshmi, qoftë për shkak të presioneve të jashtme/qeverisë apo vet-cenzurës. Sidoqoftë, duhet pranuar, se edhe raportimi më i mirë medial mund vetëm të zbulojë shkeljet dhe parregullsitë; zinxhiri institucional vazhdon më pas me policinë dhe gjyqësorin.

IV. Korniza Legjislative e lirisë së shprehjes

4.1 Përmbledhje e legjislacionit ekzistues dhe zbatueshmëria

Liria e shprehjes dhe liria e medieve janë të garantuara me Kushtetutë të Kosovës neni 40, "Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush." Në ndërkohë, neni 42 ndërlidhet në mënyrë specifike me Lirinë e medias: "Garantohet liria dhe pluralizmi i medieve ... Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare." Për më tepër, përmes Kushtetutës, Republika e Kosovës garanton të drejtat e garantuara përmes Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (ECHR) dhe Protokolet e saj, si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) dhe Protokolet e saj. Këto përmbajnë klauzolat për Lirinë e Shprehjes¹⁶.

Por korniza moderne legjislative jo domosdoshmërisht garanton dhe përkthehet në zbatueshmëri të ligjeve. Në Kosovë, liria e shprehjes dhe liria e medieve kërcënohet nga zbatueshmëria e dobët e legjislacionit, gjyqësia jofunksionale dhe shërbimi policor¹⁷, si dhe institucionet publike të

stërpolitizuara dhe redaksitë të cilave u mungon pavarësia dhe u që nënshtrohen interesave që kanë të bëjnë me politikën dhe biznesin. Mungesa e zbatimit të Ligjit të Punës gjithashtu ka ndikuar tek liria e shprehjes për gazetarët të cilët për shkak të kontratave jo të rregullta të punës janë të cenueshëm ndaj presioneve të brendshme të medieve¹⁸. Këta faktorë janë përmendur në raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe studime vendore të cilat masin në baza vjetore zhvillimet dhe progresin sa i përket lirisë së shprehjes.

1.2 Ndryshimet e parapara legjislative për vitin 2012 dhe pasojat e mundshme mbi lirinë e shprehjes

Aktualisht, Kosova gëzon Ligjin Civil për Shpifje dhe Ofendime¹⁹ i cili duhet të rregullojë të drejtën e mbrojtjes civile nga ofendimi dhe shpifja. Sidoqoftë, Ligji Penal, i cili përmban një nen mbi shpifjen, ku thuhet që personat mund të dënohen deri në tre muaj burg për shpifje, është duke u zbatuar. Në vitin 2011 një projekt ligj i ri penal është propozuar nga Komisioni për Legjislacionin i Kuvendit të Kosovës, i cili përfshin dy nene të cilat do të mund të pengonin praktikën gazetareske sa i përket lirisë së shprehjes – neni 37 dhe neni 38.

Respektivisht, neni 37 do të rregullonte çështjen e përgjegjësisë së autorëve, kryeredaktorëve, botuesve

16 Neni që garanton Lirinë e Shprehjes përfshin nenin 19 të UDHR, nenin 10 të ECHR, nenin 19 të ICCPR. Vizituar më 25 Mars, 2012. <http://www.un.org/en/documents/udhr/> <http://www.hri.org/docs/ECHR50.html> <http://www2.ohchr.org/english/law/ccpr.htm>

17 Kuvendi i Kosovës. Sipas neni 54 të Kushtetutës, "Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur." Neni 24 thotë "gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim." Neni 31 garanton "[...]Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. [...]Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të

drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/ tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj." Por Kushtetuta nuk garanton implementimin dhe gazetarët në Kosovë ballafaqohen me pengesa gjatë ushtrimit të profesionit të përditshëm. Vizituar më 25 Mars, 2012. http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution_of.the.Republic.of.Kosovo.pdf

18 Më 1 mars 2012, UNDP organizoi një takim të fokus grupit me 10 gazetarë të AGPK.

19 Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 02/L-65 "Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Ofendimit." vizituar më 25 mars, 2012. http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2006_02-L65_

dhe të tjerëve, lidhur me shkeljet penale që nuk janë të përcaktuara me Ligjin Penal – edhe pse vet përgjegjësia e personave juridik është e rregulluar me ligj të veçantë –Ligji mbi përgjegjësinë e personave juridik. Prandaj përjashton nevojën për një përgjegjësi shtesë penale vetëm për media meqë një përgjegjësi e tillë do të mund të keqpërdorej përmes kanaleve të gjyqësorit. Ndërkohë, Neni 38 për mbrojtjen e burimeve, lejon gjykatat e Kosovës të pyesin gazetarët që të shpalosin burimet e tyre gjatë raportimit të shkeljeve penale që kanë të bëjnë me degradimin e integritetit seksual, ofrimin e materialeve pornografike për personat nën moshën 16 vjeçe, keqpërdorimet në zyrë, pranimi apo dhënia e rryshfetit²⁰.

Si reagim, në letrën me datë 6 shkurt 2012, AGPK ka dërguar rekomandime anëtarëve të Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës, duke kërkuar që të hiqet neni 37, dhe të ndryshohet neni 38 në mënyrë që zbulimi i burimit të kërkohej vetëm në rast se jeta e njerëzve është rrezikuar. Në përgjigje ndaj AGPK, Ministria e Drejtësisë si sponsorues i Projektligjit Penal ka propozuar heqjen e neneve 37 dhe 38, apo ka rekomanduar ndryshimet dhe plotësimet që janë në përputhje me praktikat evropiane. Por monitorimi i ligjeve të lartpërmendura duhet të mbetet prioritet për media dhe gazetarët gjatë këtij viti në mënyrë që të sigurohet që masat e nevojshme të ndërmerren.

Një shqetësim tjetër ka qenë Rregullorja për Qasjen e Medieve në Kuvend, sipas së cilës gazetarëve u është caktuar një kënd për media në vend të qasjes së hapur në sallën e kuvendit prej ku ata në të kaluarën kanë mundur të marrin deklaratat nga deputetët. Nga mesi i vitit 2011 gazetarët kanë marrë pjesë në përpilimin e rregullores në kuadër të Grupit zyrtar Punues. Por projektligji është ndryshuar dhe miratuar, dhe Sekretariati i Kuvendit i ka hequr komentet e tyre. Edhe pse tani gazetarëve iu është lejuar qasja në sallën e Kuvendit, duhet të vazhdohet me kontrollet dhe bilancet që kanë të bëjnë me këto politika, sidomos nga ana e asociacioneve të gazetarëve, siç është AGPK. E njëjta gjë vlen edhe për ligjin mbi KPM dhe RTK, të cilat janë në fazën finale për t'u miratuar nga Kuvendi. Pengesa kryesore ka mbetur fakti që ligjet nuk janë në përputhje me standardet evropiane, siç e kërkon Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

20 Kuvendi i Kosovës "Projekt Ligji Penal." Vizituar më 25 Mars , 2012. <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Draftcriminal%20code%20of%20Kosovo.pdf>

V. Kosova në Indeksin për Lirinë e Shprehjes

5.1 Raportet Ndërkombëtare

Indeksi për Qëndrueshmërinë e Medieve, e lansuar nga IREX në vitin 2001, ofron analiza të detajuara mbi kushtet për media të pavarura në rreth 80 shtete të botës, dhe vlerëson nivelin e ofrimit të informimit objektiv të medieve duke matur treguesit për lirinë e fjalës, gazetarinë profesioniste, pluralitetin e lajmeve, menaxhimin e biznesit dhe institucionet mbështetëse²¹. Rangimi i medieve ndryshon nga E paqëndrueshme, Kundër Lirisë së Shtypit (0-1), Sistem i Përzier i Paqëndrueshëm (1-2), Afër Qëndrueshmërisë (2-3), dhe Qëndrueshme (3-4). Në sajë të Raportit për IQM në Kosovë 2011, liria e fjalës ka shënuar rezultatet më të larta nga 2.53 deri në 2.70. Ky përmirësim iu është atribuar, rezultateve më të mira për treguesit 3-hyrja në treg dhe treguesi 5- garancionet ligjore për pavarësinë editoriale për mediet publike. Studimi ka treguar që këto përmirësime kanë kundërvepruar për shkak të faktit se kishte rezultate paksa më të ulta për treguesin 4 –sulme ndaj gazetarëve, treguesin 7 – qasja në informacion dhe treguesin 8- qasja e medieve në burimet vendore dhe ndërkombëtare të lajmeve²². Treguesit 4, 6-ligjet për shpifje, dhe 7 vazhdojnë të ngecin tek treguesi për lirinë e shprehjes e cila shënon rezultatit përafërsisht tre-të katërtat e pikës. Treguesit 8 dhe 9 – hyrja e lirë në profesionin e gazetarisë kanë shënuar gati një pikë më shumë²³.

Ndërkohë që raporti vjetor i Freedom House, e cila vlerëson lirinë në botë duke iu referuar të drejtave politike dhe civile, ka ranguar Kosovën si vend pjesërisht të lirë për vitin 2011, - duke mos shënuar ndonjë ndryshim nga vitet e kaluara. Raporti thekson që “liria e legjislacionit për informacionin nuk është zbatuar në mënyrë të duhur” dhe në masë të madhe thekson faktin që “siguria mbetet një shqetësim serioz për punëtorët e medieve, dhe se ka pasur disa incidente të dhunës të raportuara në vitin 2010.”²⁴

Raporti vjetor i Progresit i Komisionit Evropian për shtetet candidate apo shtetet potenciale candidate-që përshkruan sfidat dhe të arriturat kryesore që shërbejnë si një mekanizëm esencial në matjen dhe vlerësimin e progresit të vendit – ka qenë gjithashtu kritik sa i përket lirisë së shprehjes në Kosovë, e që është përshkruar njësoj që nga viti 2007. Shembujt e shënuar në raport gjatë viteve përfshijnë: “Vullneti Politik për të mbështetur lirinë e shprehjes mbetet në nivel të ultë” (2007); “Mediet vazhdojnë të jenë të cenushme ndaj kërcënimeve politike” (2008); “Rastet e ndërhyrjeve politike kërkojnë që autoritetet e Kosovës të ndërmarrin masa më të ashpra për t’i ndaluar ato” (2009); “Gazetarët vazhdojnë të jenë nën presione, përfshirë këtu edhe të zyrtarëve të zgjedhur, si reagim ndaj raportimeve të tyre” (2010); “Gazetarët vazhdojnë të ballafaqohen me presione dhe ndërhyrje politike, të cilat kërcënojnë gazetarinë akoma të brishtë hulumtuese” (2011). Disa prej konstatimeve të përsëritura i referohen ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit Penal në mënyrë që të mos trajtohet shpifja si vepër penale. Kjo e fundit është përfshirë në vitin 2012 si një domosdoshmëri e lartë për të qenë e miratuar.

Tri raportet e fundit janë shumë të rëndësishme në kuptim të vlerësimeve vjetore të kushteve për lirinë e shprehjes në media dhe në shoqërinë e Kosovës. Treguesit dhe rezultatet e tyre flasin direkt për pengesat të cilat vazhdimisht theksohen nga gazetarët; ato tregojnë edhe faktorët kryesorë që ushtrojnë ndikim në marrëdhënien e publikut me institucionet, zyrtarët e zgjedhur, shoqërinë civile dhe mediet. Kjo e fundit ka influencuar perceptimit e publikut që tregon një besueshmëri të ultëse mediet në Kosovë gëzojnë lirinë e shprehjes, një nivel të ultë të besueshmërisë në shoqërinë civile për të vepruar si monitorues të proceseve demokratike, dhe pakënaqshmëri të lartë me qeverinë dhe partitë politike në çuarjen përpara të proceseve demokratike në Kosovë.

21 Ibid 8.

22 Ibid 8.

23 Ibid 8.

24 Ibid 9

5.2 Këndvështrimi dhe vlerësimi nga ana e medieve dhe gazetarëve të Kosovës

Në ndërkohë, në kuadër të medieve kosovare, gazetarët janë bërë gjithnjë e më të artikuluar mbi pengesat me të cilat ballafaqohen gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, identifikimin e sfidave në legjislacion dhe në kontekstin e punës në terren, si dhe nevojave për ngritjen e kapaciteteve shtesë dhe shërbimin e informacionit. Në maj 2011, kohë kjo kur perceptimi i publikut nëse mediet gëzojnë lirinë e shprehjes filloi të bie, AGPK ka zhvilluar një studim me rreth 100 gazetarë mbi temën e lirisë së shtypit në Kosovë. Të gjeturat kryesore kanë dëshmuar që gazetarët besojnë që qeveria është cenzuruesi kryesor i lirisë së shprehjes, pasuar nga partitë politike dhe gjyqësori. Këto të gjetura përkohë me të gjeturat e Pulsit Publik mbi këndvështrimet e opinionit publik që qeveria dhe partitë politike janë përgjegjës kryesor për situatën aktuale politike dhe ekonomike.

Anketa sjell vëmendjen tek fakti që varësia financiare e medieve ka ngulfatur lirinë e shtypit. Qeveria e Kosovës akoma vazhdon të jetë punëdhënësi dhe biznes kontraktuesi më i madh. Rrjedhimisht është edhe reklamuesi më i madh në medie. Prandaj pushteti qëndror dhe komunal ushtrojnë një shkallë të lartë të influencës në qëndrueshmërinë e medieve dhe suksesit apo vështirësive financiare, duke qenë që ka ndodhur që institucionet kosovare kanë kushtëzuar raportimin pozitiv në shkëmbim të reklamave. Gjatë tri viteve të fundit, autoritetet qeveritare janë akuzuar se kanë mbështetur në mënyrë indirekte disa medie që kanë ofruar mbulim të favorshëm, duke provuar të dëmtojnë financiarisht zërat më kritik duke tërhequr reklamën. Në ndërkohë mediet që janë në pronësi të kompanive të mëdha biznesore gjithashtu kanë qenë nën presion politik që lidhjet potenciale biznesore dhe kontratat me qeverinë do të mund të dëmtohen.

Në këtë mënyrë gazetarët janë vet-kritikë, por edhe vet-cenzurues për shkak të disa niveleve të ndikimit. Shumica e gazetarëve në studimin e AGPK-së kanë deklaruar që vet-cenzura e tyre kontribuon drejt një mjedisi ku liria e shtypit është e kufizuar²⁵. Një kontroll i tillë, padyshim që pasqyrohet në

përpjekjet ditore të secilit gazetar për të zhvilluar dhe ushtruar profesionin e tij/saj. Në një fokus grup të organizuar nga UNDP-ja me gazetarët e Kosovës, të mbajtur në mars 2012, gazetarët kanë bërë dallimin mes ndikimeve që vijnë nga qeveria ose partitë politike, dhe ndikimeve nga ana e pronarëve të medieve/kryeredaktorëve të cilët kanë interesa të ndërthurura politike apo biznesore.

Kufizimet nëpër redaksi janë evidente përmes përkuljeve apo animeve politike të kryeredaktorëve, të cilat tejkalojnë standardet etike dhe të pavarura. Në këtë mënyrë, gazetarët humbin vullnetin e mirë profesional dhe paanshmërinë, pasi që mungon mbështetja e nevojshme nga ana e medieve të tyre dhe shpesh rrezikojnë të humbin punën në rast se nuk i përmbushin të priturat nga redaksia. Veç kësaj, gazetarët gjithashtu bëjnë dallim në mes të gjeneratës më të vjetër dhe me përvojë në një anë, përballë gazetarëve të ri që janë më të prirur ndaj presionit dhe kërcënimeve. Rrjedhimisht, ata dekurajohen nga zbatimi i qasjes objektive, profesionale dhe etike.

Në këtë mënyrë, pengesa më e madhe ka qenë mungesa e sigurisë, dhe atë pjesërisht për shkak të kërcënimeve, sulmeve dhe shtimit të numrit të rasteve në gjykata. Gjatë vitit 2011, AGPK ka reaguar në 27 raste të shkeljes së të drejtave të gazetarëve, nëntë nga të cilat kanë pasur të bëjnë me dhunë fizike dhe shtatë të tjera kanë qenë kërcënime verbale. Një vit më parë, në vitin 2010, AGPK ka reaguar në emër të 32 rasteve. AGPK deklaroi që përkundër uljes së numrit të përgjithshëm të rasteve të raportuara, rastet e paraqitura në vitin 2011 shënojnë një numër të shtuar të sulmeve fizike. Kërcënimet ndaj gazetarëve shfaqen qoftë në mënyrë direkte përmes shantazhimit apo presioneve të ushtruara nga ata në autoritet apo pushtet, apo madje edhe direkt siç ishte rasti vitin e kaluar për dhunë fizike. Në përgjithësi, kryesit e veprave penale mbeten të pandëshkuar për shkak të ligjeve të dobëta dhe fuqizimit të dobët të rendit, duke i bërë kështu gazetarët më të cenueshëm dhe shpesh edhe duke u zbrapsur nga raportimi i drejtë. Faktorë të tillë pa dyshim kanë kontribuar drejt një mjedisi ku gazetarët ndjehen të pasigurte apo të pa përkrahur në përpjekjet e tyre ditore për të raportuar mbi procesin sfidues të demokratizimit në Kosovë. Kjo gjithashtu ka rezultuar në një gjeneratë të re të gazetarëve të cilëve u mungon stimulimi dhe vendosmëria për të zhvilluar dhe për t'u angazhuar në gazetarinë hulumtuese.

25 AGPK. "Raporti për Lirinë e Mediave të Shkruara në Kosovë." Maj 2011.

Gjatë takimit të fokus grupi të UNDP me gazetarët, ata shprehën mendimin se besueshmëria e opinionit publik në institucionin e gazetarisë është shtuar, dhe atë për shkak të storieve që mbulojnë interesat e njerëzve, ngjarjeve dhe problemeve shoqërore të cilat krijojnë marrëdhënie të besueshme dhe të qëndrueshme me audiencën e tyre²⁶. Të gjeturat e Pulsit Publik tregojnë gjithashtu që gjatë dy viteve të kaluara, shumica e kosovarëve (60%) mendonin që mediet e Kosovës nuk gëzojnë lirinë e plotë të shprehjes. Kjo mospërputhje mes gazetarëve (të cilët veprojnë si shtyllë e katërt) dhe publikut (si qytetarë të informuar që marrin pjesë në rrugët demokratike) është një tjetër tregues që pengesat me të cilat ballafaqohen gazetarët gjatë punës së tyre të përditshme duhet adresuar para se rrjedha e informacionit dhe shprehjes arrin të bëhet bazë marrëdhënies mes medieve dhe opinionit publik.

26 Ibid 18.

VI. Rekomandimet dhe veprimet pasuese

Rekomandimet në vijim synojnë të adresojnë disa prej këtyre faktorëve duke sugjeruar mënyra dhe mekanizma që AGPK do të mund t'i shfrytëzonte gjatë planeve dhe aktiviteteve aktuale dhe afatgjata për të përmirësuar mjedisin e punës sa i përket lirisë së shprehjes së gazetarëve si dhe marrëdhënieve mes medie dhe opinionit publik.

1. Miratimi i menjëhershëm i Strategjisë për Zhvillim 2012-2015 të AGPK-së nga ana e Bordit të Drejtorëve, implementimi i strukturimit operativ të organizatës në përputhje me objektivat dhe oraret e parapara në strategji.
2. Përfundimi i procesit për ri-regjistrimin e anëtarësisë përmes krijimit të një vlerësimi të bazuar në merita dhe profesionizëm për anëtarët gjatë tre muajve të ardhshëm, krijimi i një mekanizmi konsistent për mbajtjen e lidhjeve me anëtarët e vet (përveç organizimit të konferencave nga ana e AGPK) siç do të mund të ishte dërgimi i njoftimeve mujore mbi aktivitetet e muajit të kaluar dhe iniciativat për muajin vijues të cilat do të rezultojnë në një interesim, involvim dhe veprim të shtuar përcjellës nga ana e anëtarëve të saj.
3. Krijimi i një arkivi në letër dhe online të dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe operacionet e saj siç janë: raportet vjetore që përfshijnë një përmbledhje të aktiviteteve, projekteve, raporteve të auditorit, raporte financiare (gjë që do të shtonte transparencën) doracakët për gazetari, transkripte të konferencave dhe përmbledhje raportesh. Këto do të mund të shërbenin si një pikë reference për të udhëzuar gazetarët dhe për t'u ndihmuar atyre të adresojnë çështjet e tyre me interes. Në tre muajt e ardhshëm, AGPK-ja duhet të identifikojë pesë pjesëtarë që do të mund të ndihmojnë në përgatitjen e dokumenteve të tilla.
4. Të vazhdohet me reagimet publike për rastet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e gazetarëve, publikimin dhe avokimin për një mjedis të sigurtë pune për gazetarët përmes konferencave për shtyp sipas nevojës, e të cilat janë dëshmuar të suksesshme në tërheqjen e opinionit publik. Por brenda një periudhë tremujore, gjithashtu duhet krijuar një platformë në kuadër të ueb faqes ku gazetarët do të mund të postojnë ankesat lidhur me presionet e ushtruara nga ana e institucioneve për shkak të raportimit të tyre.
5. Të ofrohen shërbime tremujore elementare juridike, siç mund të jetë udhëzimi apo trajnimi në përgatitjen e qasjes në formularët dhe dokumentet zyrtare përmes organizimit të trajnimeve në çdo tre muaj në lokalet e AGPK-së, dhe gjithashtu të ofrohet edhe seksioni online me informatat e njëjta dhe formularët lehtë të shkarkueshëm që duhet të plotësohen.
6. Të krijohet një linjë telefonike direkte dhe ndërlidhëse me Policinë e Kosovës për të shtuar sigurinë në mënyrë që të ndihmohet në fuqizimin e metodave dhe mekanizmave për mbrojtjen e gazetarëve dhe lirisë së shprehjes në media. Në periudhë tre mujore të ekzaminohen strukturat e domosdoshme dhe çështjet teknike për të themeluar një mekanizëm të tillë.
7. Duke ditur që gazetarët e rinj kanë më shumë gjasa të bien viktima të shantazheve, kërcënimeve apo presioneve, AGPK do të duhej të themelonte një program aplikimi për praktikantë, përmes së cilit studentët e gazetarisë nga Universiteti i Prishtinës dhe universitetet private do të mund të përfitojnë përvojë të drejtpërdrejtë. Në periudhë prej tre muajsh të realizohet bashkëpunimi me UP dhe përpilimi i udhëzimeve për praktikantët.
8. Të bëhet anëtarë i asociacioneve ndërkombëtare të gazetarëve dhe departamenteve akademike të gazetarisë, siç është Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve dhe Federata e Gazetarëve Evropian.
9. Themelimi i departamenteve ligjore brenda organizatës që do të mund të ofronin asistencë juridike dhe këshilla gazetarëve në bazë të nevojave, të ndihmojnë gazetarët e kërcënuar dhe të ndihmojnë gazetarët me përfaqësim edhe në gjykata – kërkesë kjo që është theksuar nga gazetarët gjatë studimeve të ndryshme por edhe gjatë punës së fokus grupit të UNDP. Identifikimi dhe angazhimi i një avokati për tre muaj i cili do të merrte përsipër organizimin e departamentit..

10. Të stimulohen punëdhënësit e medieve që të implementojnë Ligjin e Punës për të siguruar kontrata të rregullta për gazetarët dhe reduktuar presionet e brendshme për media Prandaj në periudhë tremujore, të organizohet konferenca ku gazetarët dhe punëdhënësit e medieve do të merrnin pjesë për të diskutuar nevojat për zbatueshmëri.
11. Të vazhdohet me diskutimet në Forum, me përfaqësuesit nga media, gazetarët, organizatat e shoqërisë civile, qeverinë dhe bashkësinë ndërkombëtare, si dhe ngjarjet vjetore ku diskutohen arritjet dhe dështimet drejt një mjedisi ku liria e shprehjes mbizotëron. Konferenca e parë për këtë vit do të mund të organizohet pas publikimit të këtij Dokumenti të Veprimit.

